



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:055026
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05748885

CT.nr.13/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në procedurën jokontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënësit Sh (N) R, ish nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, duke vendosur lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës për shqyrtimin e trashëgimisë, më datën 29.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Pas të ndjerit Sh (N) R ish nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, me numër personal ..., i cili ka lindur më data..., ndërsa ka vdekur më data..., pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, shtetas i Republikës së Kosovës, SHPALLET për trashëgimtar, në bazë të trashëgimisë e me obligim të kthimit të borxheve eventuale të trashëgimlënësit, deri në lartësinë e vlerës së trashëguar:

- I. M (Sh) R, nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, me numër personal, përndryshe biri i të ndjerit, shpallet pronar në këtë masë trashëgimore respektivisht në pjesët si në vazhdim: 7/48, pjesë të parcelës me nr. 00070-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00092-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00185-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00493-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00494-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-1 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-2 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-3 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-4 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-5 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-6 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-7 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00723-8 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00746-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00747-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 00835-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 01257-0 ZK Celinë, 7/48 pjesë të parcelës me nr. 01258-0 ZK Celinë, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 00100K-0 ZK Celinë, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 00119K-0 ZK Celinë, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 00226K-0 ZK Celinë, 1/1 pjesë të

parcelës me nr. 00287K-0 ZK Celinë, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 00339K-0 ZK Celinë.

- II. Detyrohen trashëgimtari i shpallur M (Sh) R që kësaj gjykate në mënyrë solidare t'ia paguajë taksën gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë, në shumën prej 150.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate është iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësit Sh (N) R ish nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, pasuria e të cilit është përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata gjatë procedurës dhe nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se i ndjeri ka pasur banimin e fundit në territorin e kompetencës territoriale të kësaj gjykate, se ka vdekur më 26.03.1999, pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përvetshme, dhe se prej trashëgimtarëve të rendit të parë të trashëgimisë ka lënë trashëgimtarët dhe atë bashkëshorten N R, bijtë M.R dhe Z.R.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje të trashëgimisë, më datë 23.05.2024, ku trashëgimtari M.R, ka pranuar që të shpallet trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerit në pjesët që i takon sipas ligjit dhe në pjesët që eventualisht dikush prej trashëgimtarëve heq dorë të interes tyre, ndërsa trashëgimtarëve të tjerë nuk ua kanë mohuar të drejtën për trashëgimi, ndërsa bashkëshortja e trashëgimlënësit N R dhe dhe i biri Z R, kanë pranuar që të shpallen trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerit, mirëpo nga kjo e drejtë kanë hequr dorë në favor të birit përkatësisht vëllait të tij, M.R.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e neneve 12, 119 dhe 135 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, si dhe në dispozitat e neneve 125, 128 dhe 162.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CT.nr.13/2023, më datë 29.05.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.